-V-

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

# PROCESVERBAL
## Nga Diskutimi Publik

**I Mbajtur me banorët e Shipolit, Zhabarit dhe Koshtovës**
**Datë:20.04.2022**
**Me fillim në ora 10:00h**
**Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës**

**Prezenca e pjesmarrësve: Ekziston lista e bashkangjitur.**

**Tema: Draft Plani Harta Zonale Komunale Mitrovica Jugore 2021-2029.**

Takimin e shpalli të hapur z.Nexhmi Hasani në cilësi të Koordinatorit të procesit për Hartimin e Hartës Zonale të Komunës, i cili e elaboroi para të pranishmëve këtë draft- dokument, ku më pas fjalën i`a kaloi përfaqësuesit të kompanisë INS-i, e angazhuar për hartimin e këtij Dokumenti, ku ndër të tjera tha se ky është një dokument i rëndësishëm që ka për qëllim t`i japë zgjidhje zhvillimit të qëndrueshëm dhe rigjenerimit të qytetit, andaj i inkurajoj të gjithë pjesëmarrësit që të kontribuojn përmes dhënies së komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve gjerë në hartimin e dokumentit Harata Zonale Komunale. Dhe më pas fjalën ia kaloj kompanisë hartuese që të bëj një prezantim të shkurtër me të cilin pjesëmarrësit u njoftuan rreth asaj se çka është arritur gjerë më tani në procesin e hartimit të draft dokumentit dhe poashtu kërkuan nga publiku që të mund të shtrojnë pyetje që janë me interes e të cilat do të mund të inkorporohen në dokument.

Pas prezantimit të pikave kyçe të cilat janë pjesë të tërë procesit të hartimit të draftë dokumentit, gjithashtu u theksua se çdo element që përfshihet në dokument është i bazuar në mënyrë strikte në respektimin e Rregullatives ligjore pra në Ligjin për Planifikimin hapësinor dhe të gjitha Udhëzimet Administrative që rregullojnë këtë çështje.
Më pas u kalua në diskutim, ku disa nga të pranishmit shtruan pyetje me interes për banorët.

**Salih Meha** – në cilësi të përfaqësuesit te lagjes së Shipolit, i cili ndër të tjera theksoi se këtë lagje me vite të tëra e përcjellin probleme nga më të ndryshmet, edhe pse në këtë lagje për fat të mirë egzistojn objekte me rëndësi siç janë: shkolla fillore,qendra e mjeksisë familjare, por që duke pas parasysh faktin se aktualisht këto gravitojnë rreth dymbëdhjetë mijë banorë, kemi nevojë që ti japim disa propozime si bie fjala zgjerimi i objektit të QMF-së, vendosja apo ndërtimi i një nënstacioni policorë, ndërtimi i një shtëpie të pleqëve, ndërtimi i së paku edhe një qerdhe për fëmijë, rregullimi i objektit të kulturës,vendosja e një zyre të gjendjes civile, për faktin se kjo zyrë është e vendosur në Zhabarë, ku na duhet të kalojmë një rrugë bukur të gjatë për të marrë shërbime në këtë zyrë andaj kishim propozu që e njejta të dislokohet dhe të vendoset në Shipol. Kemi edhe një kërkesë që të vendoset shtresë e re e asfalltit duke qenëse me zhvillimin e punimeve qoftë nga distrikti i Keds-it për rregullimin e kabllit nëntoksorë apo edhe kur bëhen intervenime të kanalizimit nga Kompania e Ujësjellsit Rajonal shkaktohen dëme të ndryshme sidomos prerjet e asfalltit, largimi i kubzave në trotuar e që të shumtën e rasteve mbesin të pariparuara për qka kemi në vazhdimësi dëmtim të asfalltit. Në vendbanimin që njihet si Tmavajt, është krijuar një rrugicë e cila kalon pothuajse nëpër varreza të këtij komuniteti e që nuk ishte dashur me ndodh kjo prandaj me pasë parasysh edhe këtë çështje që në të ardhmen mos të na ndodh të ketë një rrugë të këtij lloji. Dhe si propozim tjetër kishim me cekë që para hyrjes për në varrezat kryesore që njihen si varrezat e Shipolit, të parashihet

ndërtimi i një parkingu për rastet kur njerëzit duke ardhur për ceremoni bëhet ngulfatja e lëvizjes së lirë në mungesë të parkingut gjë që është shndërruar në përditshmëri dhe është një situatë e cila përseritet vite me radhë.

**Ilir Isufi** – kam një propozim dhe i kisha bërë lutje autoriteteve përgjegjëse të komunës e poashtu edhe hartuesin e draft dokumentit që të parashohin hapjen e rrugës e njohur si "Rruga mulliri i vjetër", e cila është e bllokuar për qarkullim me vite të tëra, ku nuk mund të kalohet ndryshe veq në këmbë dhe nga ana tjetër e theksojm se kjo rrugë për ne banorët në afërsi ka një rëndësi të veqant pasi që në të kaluarën ka simbolizuar rrugën e Zhabarit.

**Shpresa Bajrami** – e shtroj pyetjen se a është paraparë që të ndërtohet edhe ura tjetër te Liqeni Akumulues i cili i ndan dy pjesët e shëtitores, pasi që na duhet të bëjmë rrugë të gjatë për të kaluar nga një pjesë një tjetrën.
Përgjigja ishte pozitive se po së shpejti do të fillojnë punimet për ndërtimin e kësaj ure.

Me qenëse nuk pati pyetje tjera :

Përfundoj në ora **11,30h.**

**Procesmbajtësi**
**Xhevdet Aruqaj**
**Zyrtarë Ligjorë**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## DISKUTIMI PUBLIK

## Draft Plani – Harta Zonale Komunale
## Me banorët e Zhabarit, Shipolit dhe Koshtovës

**DATË: 20.04.2022**

**Vend takimi:** Salla e Kuvendit të Komunës

**Me fillim në ora 10.00h**

**LISTA E PJESËMARRËSVE**

| | Emri dhe Mbiemri | Tel:/emaili: | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | FEHMI ALIU | [redacted] | [redacted] |
| 2 | Salih Maliqa | [redacted] | [redacted] |
| 3 | SHEMSEDIN BAJRAMI | [redacted] | [redacted] |
| 4 | KIR ISUFI | [redacted] | [redacted] |
| 5 | Shpresa Bajrami | [redacted] | [redacted] |
| 6 | SEBAHATE TAHIRI | [redacted] | [redacted] |
| 7 | AEBEN SEFEDINI | [redacted] | [redacted] |
| 8 | NEXHIM HASANI | [redacted] | [redacted] |
| 9 | Xhevdet Aruçaj | [redacted] | [redacted] |
| 10 | SHYHRETE PECI | [redacted] | [redacted] |
| 11 | FLORENT ABRASHI | [redacted] | [redacted] |
| 12 | Besim Ibeli | [redacted] | [redacted] |
| 13 | ARMEND SOKOLI | [redacted] | [redacted] |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 14 | Albern Frrokaj | [redacted] | |
| 15 | ARDIAN BRAHIMI | | |
| 16 | Blerim Meholli | | |
| 17 | Bedri Sadiku | | |
| 18 | BESIM BEKA | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |
| 36 | | | |
| 37 | | | |